

## SHKOLLA SHQIPE ME MËSIM PLOTËSUES, REALITET NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË

Çdo popull përcjell identitetin e tij nëpërmjet gjuhës së vet, e cila është një pasuri e madhe për secilin shtetas të kombit që ai përfaqëson, sepse çdo gjuhë ka historinë e vet, marrëdhëniet me gjuhët e tjera, zhvillimet, arritjet, por ka edhe misteret e veta, ashtu siç ka dhe fatin e vet, them fatin e vet, sepse në pak javë i takon të zhduket një gjuhë.

Gjuha e folur shqipe rrjedh nga thellësia e shekujve, nga ilirishtja, arbërishtja, shqipja. Ajo u rezistoi të gjitha stuhive të përplasura mbi të. Sot është ndër 5-6 gjuhët më të rëndësishme në Europë dhe ndër 11 gjuhët më të rëndësishme në botë. Gjuha shqipe flitet në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në diasporë.

Fillimet e veta diaspora i ka që nga ilirët, të cilët u vendosën në gadishullin Apenin, në mënyrë të organizuar. Përfaqësues nga kjo diasporë ndikuan në vendime të rëndësishme të Perandorisë Romake, ku pati dhe periudha të caktuara, që arritën ta udhëhiqnin atë.

Në mesjetë, ashtu si dhe vende të tjera të botës, pjesa më e madhe e popullsisë në Shqipëri nuk dinte të shkruante e të lexonte. Vendet ku mësohej shkrim e këndim, ishin kishat dhe manastiret. Disa nga nxënësit, pas përfundimit të shkollave vendase, vazhdonin kolegjet ose universitete jashtë vendit, p.sh.: në Napoli, në Romë, në Selanik etj. Po në këtë periudhë, diasporën shqiptare e gjejmë të organizuar në formën e kolonive, të cilat e ruajtën identitetin e tyre.

Në fillimet e Perandorisë Osmane, në vendin tonë, një pjesë e madhe e fisnikëve vendas u larguan drejt Italisë të organizuar në formën e kolonisë. Kjo popullsi mori me vete gjuhën, zakonet, traditat etj. Këtu gjejmë dhe zanafillën e shkollës shqipe. Në vitet

1500-1502 në Venedik, Marin Biçikemi hapi shkollë për fëmijët arbëreshë. Në shkollë bëhej punë e mirë për ruajtjen e gjuhës amtare dhe të kulturës shqiptare.

Në shkollën e Lek Matrëngës mësohej gjuha amtare dhe vetë Lek Matrënga përktheu në shqip katër libra katekizmi, kështu dhe mësimet fetare merreshin në gjuhën amtare. Në fillim të shekullit XVIII u themelua kolegji i Shën Adrianit. Me përpjekjen e Jeronim de Radës, në këtë kolegji u vendos mësimi i gjuhës shqipe. Vetë De Rada ishte mësuesi i kësaj gjuhe. Në vitin 1851 kjo katedër u mbyll. Më pas, katedra e gjuhës shqipe u shpërngul në Shën Miter Koronë të Kalabrisë. Këtu kanë studiuar Aleksandër Xhuvani, Luigj Gurakuqi etj.

Shkolla në gjuhën shqipe gjejmë në Zarë, Rumani, Bullgari e në vende të tjera. Në Rumani hapet shkollë Normale për fëmijët shqiptarë dhe vllahë. Kjo shkollë u hap nga Nuçi Naçi dhe në të studiuuan Kristo Luarasi, Asdreni, Mihal Grameno etj. Kristo Luarasi punonte si tipograf, ku bëheshin botime të librave shqip. Mihal Grameno u bë i njohur si publicist.

Në horizont shfaqet një diasporë e re, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku atdhetari Petro Nini Luarasi hap kurse analfabetizmi me emigrantët ekonomikë.

Po kështu, në vitet 1920-1921, në Stamboll kemi gjashtë shkolla shqipe të hapura dhe drejtuara nga Riza Drini. Në shkollën shqipe të Argjentinës vazhdoi mësimi i fëmijëve dhe emigrantëve të rritur deri në prag të Luftës së Dytë Botërore

Pas Luftës së Dytë Botërore (në vitet '60 të shekullit të kaluar) qindra e mijëra familje nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia morën rrugën e kurbetit. Me vendosjen e shqiptarëve në vendet pritëse filloi dhe mësimi i gjuhës amtare në kuadër ShShMP për emigrantët jugosllavë, mësim që organizohej nga shkolla vendase në bashkëpunim me ambasadën dhe konsullatën Jugosllave. Mirëpo kishte raste kur fëmijët shqiptarë frekuentonin mësimin plotësues jo në gjuhën shqipe, por në atë serbokroate. Kështu, shumë mësues dhe prindër patriotë bënë përpjekje për mësimin e gjuhës amtare duke arritur në sukses. Po kështu, u krijua në Prishtinë LASH (Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë), si dhe degë të kësaj lidhjeje në Europë, në vende ku po hapeshin shkolla

shqipe me mësim plotësues, si: Gjermani, Zvicër, Norvegji etj. Shkollat shqipe me mësim plotësues ndikuan në ruajtjen e ndjenjave atdhetare, saqë pati edhe nxënës të këtyre shkollave që shkonin për të mbrojtur Kosovën nga millosheviçjanët e tërbuar. Një ndihmesë me vlerë të madhe për mësuesit dhe nxënësit në diasporë ka dhënë didakti prof. dr. Shefik Osmani, i cili, pa u lodhur, punoi me bashkautorët Abdyl Rama, Meriman Braha, Munish Hyseni (dhe me bashkatdhetarë të tjerë në Gjermani, Zvicër etj.). Nën drejtimin shkencor-pedagogjik të vetë prof. Shefik Osmanit, botojnë Abetaren dhe serinë e teksteve “Zemra ime” për klasat II dhe III fillore. Më pas botuan tekstin “Shkollë dhe jetë” për klasat IV, V, VI dhe “Bota Shqiptare” për nxënësit e rritur. Në Suedi u botua teksti “Urat tona II” për të rinjtë shqiptarë etj.

Pas viteve 1981-1998, nga Kosova dhe Maqedonia pati shpërngulje të popullsisë për shkak të ngjarjeve të ndodhura. Pas viteve 1990-1997, pati shpërngulje të theksuara të familjeve nga Shqipëria drejt Europës Perëndimore, kryesisht pjesa më e madhe u vendos në Itali dhe Greqi, si dhe në vende të tjera të botës.

Siç përmenda më lart, arbëreshët janë vendosur në Italinë e Jugut dhe afër pjesës qendrore, në Kalabri, Sicili. Ata ruajtën gjuhën, zakonet e të parëve, pra identitetin e tyre. Në familje flasin shqipen e hershme, por jo vetëm kaq. Në këtë vend, ku ata jetojnë prej shekujsh, u është afruar shkolla, kisha, muze, administrata etj. Gjithashtu, janë të njohura festivalet e tyre folklorike. Kjo popullsi pëlqen të folurën arbëreshe, ku gjejmë shkrime të ndryshme apo fjalorë, etj. Kjo gjuhë e ruajtur me kaq fanatizëm, ka ardhur deri në ditët tona, duke u bërë urë lidhëse midis dy popujve.

Eksodi i dytë i madh vendosi në këtë vend afërsisht një milion shqiptarë, të cilët shkuan në kërkim të mundësive për të punuar. Me fëmijët e lindur në Itali, po rritet brezi i dytë, prandaj është i domosdoshëm mësimi i gjuhës amtare. Kështu, shoqata të ndryshme të krijuara janë marrë me mësimin e gjuhës shqipe, për t'i grupuar fëmijët një ditë të caktuar. Mësuesit e zhvillojnë mësimin vullnetarisht, ata kanë kërkuar dhe kanë gjetur mbështetje nga komunat, për të pasur në dispozicion mjedise për të zhvilluar mësimin e gjuhës shqipe një ose dy herë në javë, pasdite ose në ditë pushimi. Tekstet që përdoren në këto shkolla,

janë gjetur nga mësuesit ose u janë dërguar nga ambasada.

Në 1999, parlamenti italian miratoi ligjin për mbrojtjen e pakicave gjuhësore, ku në të bën pjesë dhe gjuha shqipe. Kultura e popullit italian ka në gjirin e vet 12 etni, ku shqiptarët zënë vendin e dytë pas pakicave tiroleze në Veri. Këto etni gjejnë veten në këtë vend, pasi ato flasin, mësojnë dhe shkollohen në gjuhën e tyre amtare. Në mesin e etnive bën pjesë dhe gjuha shqipe, e cila tani e në të ardhmen do të mësohet në shkollat italiane. Kështu, kupton se ky vend demokratik respekton të Drejtat Themelore të Njeriut dhe rrit qytetarë demokratë.

Në diasporë u krijua LAPSh (Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë). Kjo lidhje mori përsipër jo vetëm hapjen e shkollave shqipe, por me fondin e mbledhur nga kuota e çdo anëtari të shoqatës (do të paguante një shumë që të ishte e përballueshme, edhe nëse prindërit do të ishin me përkrahje sociale). U bënë botime të teksteve për çdo grup-moshë, gjithashtu u bë edhe trajnimi i mësuesve etj.

Në Zvicër, mësimi plotësues zhvillohet në orarin e mësimin të rregullt në disa kantone. Kjo ndodh aty ku kantoni e bën financimin e mësuesve, tërësisht ose pjesërisht. Ndërsa në kantone të tjera, financimi bëhet nga prindërit, sipas rregullave të shkruara në fletëpalosje. Numri i nxënësve që frekuentonin shkollën shqipe me mësim plotësues në vitin shkollor 1991-1992 ishte 986 nxënës, ndërsa në vitin 2004-2005 numri i nxënësve ishte 3263.

Mësuesit, që morën përsipër mësimin e gjuhës shqipe, patën përkrahje dhe nga mësues e pedagogë zviceranë, të cilët së bashku hartuan tekste shkollore për nxënësit shqiptarë. Prof. dr. phil. Basil Chader është bashkautor i tekstit shqip, fjalorit "Udha e Fjalëve", dhe autor i veprës "Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër", Tiranë, 2005.

Shkollat shqipe në Zvicër kanë një shtrirje në të gjitha kantonet. Një pasqyrë të qartë të shkollave shqipe e gjejmë në librin "Historia e shkollës shqipe të mësimin plotësues në Zvicër", i prof. dr. Shefik Osmani dhe doc. mas. Mahir Mustafa, ku paraqiten hartat e kantoneve me komunat ku gjenden shkollat shqipe të mësimin plotësues, si dhe të dhënat arsimore.

P.sh., kantoni i Argaut ka këto shkolla shqipe:

1. Dotikon (19)
2. Frick (17)
3. Laufenburg (15)
4. Leibstadt (10)
5. Menziken (13)
6. Meri (19)
7. Reiden (15)
8. Reinach (29)
9. Rheinfelden (38)
10. Suhr (13)
11. Siglistorf (13)
12. Unterentfelden (24)
13. Èindisch (18)

*Të dhëna arsimore:*

- Rrjeti i ShShMP-ve vazhdon duke u përmirësuar, deri sa u normalizua duke filluar nga viti shkollor 1991-1992.
- Mësuesit bashkëpunojnë me institucionet zvicerane.
- Ata ndjekin programin e MASHT.
- Financimi bëhet nga prindërit.

ShShMP ka si qëllim t'i përgatisë të rinjtë shqiptarë për të përballuar jetën.

Ajo është një institucion arsimor-edukativ, institucion kombëtar, ku përfshihen fëmijë të moshës 6-16 vjeç. Mësimi, në këto shkolla zhvillohet një ditë në javë. Klasat janë të veçanta, kur plotësohet numri i nxënësve, ndërsa kur numri i tyre është i pakët, mësimi zhvillohet me klasa të bashkuara. Struktura e arsimit ndahet në tri cikle:

Cikli i ulët, i cili përfshin klasat I-II-III, për moshën 6-10 vjeç.

Cikli i mesëm, i cili përfshin klasat IV-V-VI, për moshën 9-13 vjeç.

Cikli i lartë, i cili përfshin klasat VII-VIII-IX, për moshën 13-16 vjeç.

Në Suedi punojnë 140 mësues në ShShMP. Këtu mësimi është i institucionalizuar. Suedia ka 15 mijë nxënës, që për gjuhë amtare kanë gjuhën shqipe dhe kudo ku janë vendosur shqiptarët, ka shkolla shqipe me mësim plotësues. Për të vazhduar mësimin në gjuhën amtare, duhet që çdo vit prindërit të plotësojnë një formular, ku të deklarojnë se përdorin gjuhën amtare në familje. Sipas ligjit suedez për shkollat, ku ka 5 e më shumë nxënës të cilët nuk e kanë suedishten gjuhën amtare, ekziston e drejta që ata, disa orë mësimi në javë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Çdo nxënës në shkollën suedeze ka të drejtën e vet të bëjë përzgjedhjen e mësimin të gjuhës së dytë.

Mësimi i gjuhës shqipe është i institucionalizuar dhe në shkollat austriake.

Në Greqi, mësimi i gjuhës amtare zhvillohet në mjedise të mara me qira, ose pranë shkollave vendase, ditën e diel nën kujdesin e shoqatave të ndryshme. Mësuesit punojnë vullnetarisht, por me përkushtim për ruajtjen e gjuhës dhe identitetin kombëtar. Por hasen dhe një sërë vështirësish:

- *Informimi i emigrantëve për gjuhën shqipe.* Ka shumë shqiptarë që nuk e dinë se fëmija i tyre ka mundësi të mësojë shqip.
- *Bindja e emigrantëve për mësimin e gjuhës shqipe.* Rëndësia e të mësuarit shqip te fëmija i tyre.
- *Gjetja e mjediseve për zhvillimin e mësimin.* Kjo është shumë e vështirë. Mjediset merren me qira dhe përzgjidhen që të jenë të përshtatshme dhe jo larg nga vendbanimet e nxënësve.
- *Materialet didaktike,* që janë të domosdoshme për zhvillimin e orës së mësimin, shpesh sigurohen nga mësuesit, kur kanë mundësi t'i përgatisin. Në shumicën e rasteve mungojnë, kështu ora e mësimin bëhet e thatë
- *Mësues që e kanë harruar profesionin e tyre,* për arsye të shkëputjes së gjatë prej tij. Apo mësues të rinj, pa përvojë pune, të cilët hasin vështirësi gjatë mësimdhënies.
- *Sensibilizimi për forcimin e dygjuhësisë,* e cila vlen për të ardhmen e fëmijës së tyre.
- *Tekste me përmbajtje jo të përshtatshme për këtë kontingjent fëmijësh.*

Qëllimi i shkollës shqipe në diasporë është që brezi i ri të zotërojë gjuhën amtare, të njohë letërsinë, historinë, gjeografinë e vendit të tij, të njohë doket, zakonet, mentalitetin shqiptar dhe t'i transmetojë brez pas brezi.

Në të gjitha vendet, ku janë hapur shkolla shqipe me mësim plotësues, zhvillohen seminare me tema të ndryshme, në dobi të mësuesve dhe mësimin në gjuhën shqipe. Po ashtu, zhvillohen seminare në bashkëpunim me pedagogë dhe mësues vendas, duke shfrytëzuar përvojën e tyre (brenda dhe jashtë vendit), sepse disa vende të fuqishme kanë ngritur në vendet ku ka shumë emigracion, edhe shkollat e tyre, siç janë shkollat gjermane, franceze etj., po ashtu dhe vende më të vogla, si Greqia, me të gjitha parametrat e arsimit të tyre. Mësuesit, të cilët janë të përkushtuar për të punuar pranë këtyre shkollave, duhet të jenë në nivelin e mësuesve të vendeve pritëse. Në morinë e madhe të tyre do të përmendja mësuesen e pasionuar Nexhmije Mehmetaj (mësuese në Zvicër), e cila, me një kulturë të shkëlqyer shkencore dhe pedagogjike, çdo ditë përgatit për 80 nxënësit e saj në gjashtë shkolla të kantonit ku ajo punon, materiale mësimore për të arritur objektivin e orës së mësimin.

Osman Ademi, mësues në Vjenë, do të konsultohet me mësuesit e shkollës vendase për të gjetur rrugë, që nxënësit të ecnin dhe në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe. Valbona Hystuna dhe gjithë mësuesit, të cilët punojnë të përkushtuar pranë shkollave shqipe në Greqi, duke u dhënë pjesë nga koha e tyre, pa asnjë lloj shpërblimi financiar, për dhjetë vjet rresht. Masa për mosasimilimin e gjuhës amtare janë marrë sidomos nga qeveria e Kosovës, e cila hartoi kurrikulën për shkollat shqipe me mësim plotësues në diasporë.

Tani në MASH, Shqipëri, është krijuar një sektor i ri për diasporën, i cili merret me organizimin dhe furnizimin e kësaj diaspore me tekste. Tekstet "Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare" 1, 2, 3, janë ndërtuar në bazë të programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe jepen falas. Organizohet, gjithashtu, edhe trajnimi i mësuesve etj. Gjithashtu, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Shqipërisë organizojnë çdo vit seminarin

mbarëkombëtar me mësues nga diaspora. Në këto seminare shkëmbehet përvoja e mësuesve, njihen me tekste të reja etj.

Për herë të parë në hapësirën shqiptare, Universiteti “Akademia Pedagogjike e Tiranës” ka në kurrikulën e saj ShShMP, ku studentët marrin njohuri të thelluara për veprimtarinë dhe zhvillimin e mësimit në këto shkolla. Vetë rektori i saj, prof. dr. Musa Kraja, ka shkruar “Disa probleme didaktike në shkollat shqipe me program plotësues” dhe tani kemi në proces tekstin “Pedagogjia, shkolla shqipe me mësime plotësues”. Gjithashtu, rektori i Akademisë ka marr pjesë në seminarin mbarëkombëtar për diasporën. Kjo Akademi ka lidhje me mësues nga gjithë diaspora nëpërmjet postës elektronike, si dhe ndjek seminare të larmishme që zhvillohen në diasporë, duke qenë gjithmonë më afër saj. Mendoj se kemi numrin më të madh të emigracionit në botë, për sa i përket numrit të popullsisë që ka Shqipëria.

Studimet kanë treguar se gjuha amtare ka rol qendror dhe kryesor për zhvillimin gjuhësor dhe suksesin shkollor. Përvetësimi i gjuhës amtare, njëkohësisht me gjuhën (e vendit ku ata mësojnë) e mësimit i ndihmon në përvetësimin e gjuhës së dytë. Gjithashtu, aftësia e analizës gjuhësore, si dhe cilësia dhe sasia e strategjive për përvetësimin e një gjuhe janë më të larta te fëmijë me dygjuhësi, se me një gjuhë.

Shkencëtarët e Universitetit të York (Angli) kanë dalë në përfundimin se zotërimi i një gjuhe të dytë është mirë për shëndetin mendor, sepse rritet “fleksibiliteti mendor”. Udhëheqësi i studimit, dr. Ellen Biolystak thekson: “Studimet e mëparshme kanë dalë në përfundimin se mësimi i një gjuhe të huaj në moshë të vogël i ndihmon fëmijët në aftësinë e tyre komunikuese, ndërsa studimi ynë tregon se gjuha e huaj ndihmon edhe në shëndetin mendor në të ardhmen afatgjatë”. Kërkimi tregon se “manovrimi” në një apo në shumë gjuhë të huaja aktivizon zona të caktuara të trurit dhe “stërvitja e tyre është me leverdi për të ardhmen”.